



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Në partneritet me Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor RELOAD2

UDHËZUES PËR APLIKANTËT

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-TË), QË NË KUADËR TË THIRRJES PUBLIKE, FTOHEN TE PARAQESIN PROJEKT PROPOZIME FINANCIAR NGA BASHKIA KORÇË ME MBESHETJEN TEKNIKE TË PROGRAMIT RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (RELOAD2)

1. NJOFTIMI I THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME

Bashkia Korçë , me anën e këtij udhëzuesi synon të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të interesuara për dorëzimin e projekt-propozimeve në kuadër të Thirrjes Publike për OShC-të, financuar nga fondet e buxhetit të Bashkisë për vitin 2023.

Pas eksperiencës së fituar gjatë zbatimit me sukses të metodologjisë LOD dhe memorandumit të mirëkuptimit të lidhur midis Bashkisë Korçë dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), në kuadër të zbatimit të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (RELOAD2), Bashkia garanton një proces të hapur dhe transparent aplikimi dhe vlerësimi të projekt propozimeve.

Disa nga rezultatet që RELOAD2 do të arrijë në bashkitë partnere në Shqipëri dhe vendet e Ballkanit Perëndimor janë:

- ◆ Forcimi i kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore dhe OShC-ve për të institucionalizuar dhe zbatuar skema granti transparente dhe me ndjeshmëri gjinore dhe njëkohësisht zbatimi cilësor i projekteve që i shërbejnë komunitetit.
- ◆ Rritja e kapaciteteve të autoriteteve vendore dhe OShC-ve për të gjeneruar angazhim më të madh qytetar dhe të rinjve në çështjet vendore;
- ◆ Përmirësimi i rrjeteve dhe dialogut rajonal midis shoqërisë civile dhe njësive të qeverisjes vendore në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

2. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E THIRRJES

Nëpërmjet kësaj thirrje publike synohet forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njësive të pushtetit vendor. Kjo do të arrihet nëpërmjet zbatimit të projekteve nga OShC-të për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Në këtë kuadër, ftohen të gjitha OShC-të e interesuara të

**BASHKIA KORÇË**

dorëzojnë projekt-propozime, të cilat duhet të kontribuojnë në përmbushjen e prioritetit strategjik të përzgjedhur nga Bashkisë Korçë, duke adresuar nën-prioritetet si më poshtë:

Prioriteti 1: Promovimi dhe zhvillimi i turizmit nëpërmjet ideve kreative dhe inovacionit.

Prioriteti 2: Promovimi i turizmit sportiv përmes nxitjes së ekipeve profesioniste dhe amatore për zhvillimin e seancave stërvitore dhe ndeshjeve sportive pranë fushave dhe terreneve sportive në Korçë.

Procesi i konsultimit të dy prioritetëve më sipër, u realizua në takimin e organizuar pranë Bashkisë Korçë me pjesëmarrjen e OSHC-ve, në datë 21/ 06/ 2023, Ora 12:00.

Fondet do t'u ndahen atyre organizatave, projektet e të cilave i kontribuojnë zgjidhjes së një apo më shumë prioritetëve të Bashkisë përkatëse, që përmbushin kriteret e cilësisë dhe kushtet e tjera të kësaj thirrje publike, sikurse përcaktuar në këtë Udhëzues.

3. FONDET (GRANTET) QË JANË NË DISPOZICION PËR PROJEKTE

Vlera e granteve që ndahen si pjesë e kësaj thirrje publike duhet të jetë në shumën maksimale si më poshtë:

- shuma maksimale: **2.000.000 Lekë**

Grantet e alokuara në këtë thirrje publike mund të mbulojnë shpenzimet administrative dhe shpenzimet e personelit deri në masën 30% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 70% të fondeve, duhet të parashikohen për aktivitete programore të projektit.

Ndërkohë, deri në 30% e vlerës totale mund të parashikohet për blerje pajisjesh dhe /ose për rikonstrukcione/infrastrukturë, vetëm në rastet kur janë të domosdoshme për realizimin e qëllimit të projekt propozimit.

Për secilin projekt, 4% e vlerës totale të propozuar duhet të parashikohet për aktivitete që lidhen me dukshmërinë/vizibilitetin.

Totali i grantit në Bashkinë Korçë për këtë Thirrje është: **2.000.000 Lekë.**

Bashkia Korçë ka të drejtën të mos shpërndajë të gjitha fondet në dispozicion, nëse projekt- propozimet që dorëzohen nga OSHC-të nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

4. KUSH MUND TË APLIKOJË

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për OSHC-të (shoqatat, qendrat ose fondacionet) që janë zyrtarisht të regjistruara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Shqipëri.

Aplikantët e mundshëm nuk mund të marrin pjesë në thirrje ose nuk do të marrin grante nëse nuk dorëzojnë bashkë me projekt-propozimin deklaratën e nënshkruar të përmbushjes së kriterëve (Shtojca 13).

OSHC-të do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e granteve nëse në kohën e dorëzimit të projekt propozimeve:

- janë degë/zyra të organizatave dhe fondacioneve ndërkombëtare, dhe organizatat të tjera ndërkombëtare jo-fitimprurëse të regjistruara për të punuar në Shqipëri;
- janë subjekt i ndonjë konflikti të interesit, sikurse parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”. Gjithashtu, përjashtohen nga vlerësimi ato projekte, në të cilat: Drejtori ekzekutiv, anëtarët e bordit apo personat e planifikuar për t’u përfshirë në projekt, si dhe personat e lidhur me ta sipas legjislacionit në fuqi¹, janë të punësuar në bashkinë apo institucionet e saj të vartësisë në të cilën aplikohet, në pozicionet: Zyrtari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak, anëtar i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.
- janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e projekt-propozimeve ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimit;
- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas pikës 9;
- vlera e buxhetit të propozuar është deri në 2,000, 000 Lekë;
- kohëzgjatja e propozuar e projektit është 6 muaj deri në 8 muaj.

5 . KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e projekt – propozimit do të jetë 6 muaj deri në 8 muaj.

6. VENDI I ZBATIMIT

Projektet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Korçë.

7. LLOJET E PROJEKTEVE

- Projekt-propozimet që do të financohen nga Bashkia Korçë duhet të jenë të përgatitura në përputhje me thirrjen publike dhe prioritetet e Bashkisë Korçë.
- Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të komunitetit lokal dhe grupeve të targetuara të identifikuara nga projekti.

¹ Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Për qëllim të këtij udhëzuesi, palë e lidhur janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e drejtorit ekzekutiv/anëtarit të bordit/personave të parashikuar për t’u përfshirë në projekt, e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

**BASHKIA KORÇË**

- Projektet duhet të jenë paketa veprimtarish të integruara dhe metodologjike, të krijuara për të arritur qëllime të caktuara dhe rezultate specifike në kuadër të një periudhe të kufizuar kohore.

Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për ndarjen e granteve:

- Aktivitetet e rregullta të organizatës aplikuese apo organizatës partnere;
- Sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Konferenca të herëpashershme (përveç nëse janë të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit);
- Financimi i projekteve që tanimë janë në proces ose kanë përfunduar;
- Projektet për përfitime ekskluzive të individëve;
- Projektet që mbështesin partitë politike;
- Ndarjen e granteve për palë të treta;
- Blerja e pajisjeve dhe punët rehabilituese/ndërhyrjet në infrastrukturë përveç rasteve kur janë patjetër të domosdoshme dhe brenda limiteve të shprehura në pikën 3 të Udhëzuesit.

Aktivitet e sipërpërmendura **NUK** janë shkak për refuzimin automatik të projekt - propozimit, megjithatë do të ndikojnë negativisht në vlerësimin e projekt propozimit. Gjithashtu, nëse projekt – propozimi aprovohet për financim, aktivitete të tilla dhe fondet e parashikuara për to do të eliminohen.

8. PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMI

OSHC-të e interesuara mun

d të aplikojnë në mënyrë individuale ose në partneritet me organizata dhe/ose institucione të tjera.

Organizatat partnere

Partnerë të projektit mund të jenë organizata të tjera të shoqërisë civile. Partnerët e OShC-së kandidate marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e projektit, dhe shpenzimet u nënshtrohen rregullave të njëjta si ato të bëra nga vetë OShC-ja kandidate. Në këtë mënyrë, organizata partnere duhet të përmbushë kushtet e njëjta të legjitimitetit sikurse edhe organizata aplikuese. Nëse aplikojnë në partneritet, organizata aplikuese do të jetë organizata udhëheqëse, dhe në rast të përzgjedhjes, kjo organizatë do të jetë pala kontraktuese (përfituese) dhe do t'i marrë të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe financiare për zbatimin e projektit.

Deklarata e Partneritetit (Shtojca A) duhet të plotësohet në mënyrë korrekte dhe duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tjera të aplikimit.

Bashkëpunëtorët: organizata dhe institucione te tjera

Organizatat dhe/apo institucionet tjera (p.sh. shkollat, kopshtet e fëmijëve, muzetë, etj) mund të përfshihen në projekt. Organizatat bashkëpunëtoresh kanë rol të rëndësishëm në zbatimin e aktiviteteve, mirëpo nuk janë përfituese të grantit.

**BASHKIA KORÇË****9. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR***I. Dokumentet kryesore:*

- Projekt propozimi (në formatin Word - Shtojca 7)
- Buxheti (formati Excel - Shtojca 8)
- Matrica e kornizës logjike (formati Word – Shtojca 9)
- Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë (formati Excel – Shtojca 10)

II. Dokumente shitesë

- Vendimi i regjistrimit të organizatës në Gjykatë dhe ndryshime të tij nëse ka patur.
- Kopja e statutit të organizatës (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka),
- Formulari i kompletuar identifikues administrativ (formati Word– Shtojca 11),
- Formulari i kompletuar identifikues Financiar (formati Excel– Shtojca 12),
- Deklarata e plotësimit të kriterëve e plotësuar dhe e nënshkruar (formati Word – Shtojca 13),
- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash floë; ç. shënimet shpjeguese) për vitin paraardhës e firmosur nga një kontabilist i miratuar ose financieri i OSHC-së sipas kriterëve në fuqi, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Një raport përshkruar i projekteve dhe aktiviteteve të OSHC-së për vitin paraardhës, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Deklarata e partneritetit në rast se OSHC aplikuese ka partnerë (shtojca A).
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B).

Shënim: Me qëllim vlerësimin e projekt – propozimit, dokumentacioni kryesor dhe ai shitesë janë njësoj të vlefshme dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të sipër përmendura në 3 kopje është i detyrueshëm.

10. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Dokumentacioni për thirrjen publike për Bashkinë Korçë mund të tërhiqet prej **06/ 07/ 2023** duke e dërguar një kërkesë me emrin e organizatës së interesuar në e-mail adresën: bashkiakorçe@gmail.com apo personalisht, në adresën:

Bashkia Korçë
Lagjja Nr.12, Bulevard “Shën Gjergji”, Nr. 12 Korçë

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret edhe nga faqja e internetit: <http://www.bashkiakorçe.gov.al>

Aplikimet e plotësuar me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në tre (3) kopje fizike dhe në një kopje elektronike (në USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës (prej të hënës deri të premten), nga ora 09:00 deri në ora 15:00, në adresën:

Bashkia Korçë
Lagjja Nr.12, Bulevard “Shën Gjergji”, Nr. 12 Korçë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data **10 Gusht 2023, ora 15:00**. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar **emri i thirrjes publike për projekt-propozime, emri i plotë dhe adresa e aplikantit, emri i plotë i projektit** dhe fjalët: **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**. Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

**BASHKIA KORÇË**

Bashkia do të regjistrojë çdo aplikim të marrë në dorëzim dhe do të lëshojë vërtetimin përkatës (datën dhe orën e pranimit të projekt-propozimit).

11. INFORMACION TJETËR

Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, Bashkia Korçë do të organizojë një takim informues mbi Thirrjen publike, ku ftohen të marrin pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në përgjigje të kësaj Thirrje. Takimi informues ka si qëllim, informimin e OSHC-ve mbi elementët kryesorë të Thirrjes, duke u fokusuar tek elementët më të rëndësishëm për OSHC-të. Për Bashkinë Korçë takimi informues do të organizohet në datë **31.07.2023 ora 12:00**, pranë Bashkisë Korçë.

Në rast se kërkohen informacione dhe sqarime shtesë, OSHC-të e interesuara mund të dërgojnë kërkesa dhe pyetje me referencë për Thirrjen Publike në adresën: bashkiakorçe@gmail.com
Kërkesat mund të dërgohen deri një javë përpara mbylljes së thirrjes dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara do të dërgohen me shkrim brenda 5 ditëve pas pranimit të kërkesës.

12. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE***Vlerësimi***

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, përfaqësuesit e Bashkisë Korçë dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile. Përfaqësuesit e UNDP/Projekti RELOAD do të kenë roline vëzhguesit në procesin e Vlerësimit.

Shënim: OSHC-ja, përfaqësuesi i së cilës është anëtari i Komisionit të vlerësimit në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë civile, nuk ka të drejtë të aplikojë në këtë thirrje as si aplikant kryesor dhe as si partner. Përfaqësuesi i shoqërisë civile në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit, zgjidhet me një proces të hapur dhe konkurrues.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(i) Kritereve administrative:

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin 10 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit nr. 9;
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (USB).
- Konfirmimi se organizata aplikuese, partneri (dhe bashkëpunëtorët, nëse ka ndonjë) dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në seksionet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 (të përcaktuara më sipër).

(ii) Kritereve të përmbajtjes/vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:

Vlerësimi i cilësisë së projektit, përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:

**BASHKIA KORÇË**

Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nën-seksione: *Secili nën-seksion duhet të vlerësohet me pikët e caktuara nga 1 në 5, në këtë mënyrë: 1= shumë keq; 2= keq; 3= pranueshëm; 4= mirë; 5= shumë mirë.* Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin projekt propozim. Radhitja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë ku projekt propozimi i radhitur si i pari është ai i cili ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek projekt propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit për një projekt – propozim janë 100;
- Projektet do të meren në konsideratë për dhënien e grantit, vetëm nëse vlerësohen me më shumë se 75 pikë;

Vendimi për aprovimin e grantit mbështetet mbi numrin e përgjithshëm të projekteve që mund të financohen me buxhetin në dispozicion. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve do të kenë prioritet gjatë dhënies së granteve.

Shënim për Seksionin 1/Tabela e Vlerësimit: Kapaciteti financiar dhe operativ i organizatës aplikuese

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 10 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që organizatat kanë në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të rregullta gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit si dhe kanë aftësi profesionale dhe kualifikime të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. E njëjta vlen si për organizatën aplikuese ashtu edhe për partnerët.

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 10 pikë.

Shënim për Seksionin 2/Tabela e Vlerësimit: Relevanca

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 18 ose më shumë pikë, në seksionin 2. Kjo nënkupton që projekti duhet të jetë relevant me qëllimin e thirrjes publike dhe fushat prioritare, cilësia e projektit, rezultatet e pritshme dhe qëndrueshmëria e projektit janë të konsiderueshme si dhe fondet që kërkohen janë në përputhje me aktivitetet e parashikuara.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 18 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti i ka kapacitetet financiare dhe operative, koncepti i projektit nuk është relevant apo në përputhje me përparësitë e përcaktuara në thirrjen publike/ projekti nuk trajton nevojat e komunitetit.

Tabela e vlerësimit

**Tabela e vlerësimit**

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët mesatare
1. Kapacitetet financiare dhe operative	15	
1.1 A kanë aplikanti dhe partnerët përvojë të mjaftueshme në menaxhim projektesh? <i>Vlerësim maksimal marin organizatat që kanë të paktën 3 projekte të zbatuara apo në zbatim</i>	5	
1.2 A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante) <i>Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte në fushën për të cilën aplikojnë.</i>	5	
1.3. A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme menaxhuese? (përfshirë personelin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)? <i>Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte me shuma mbi 10.000 Euro.</i>	5	
2. Relevanca	25	
2.1. Sa relevant është projekti krahasuar me synimin dhe me një apo më shumë përparësi të përcaktuara në thirrjen publike? <i>Shënim: 5 pikë (shumë mirë) mund të jepen vetëm nëse projekti trajton të paktën një prej përparësive të bëra publike në thirrjen e shpallur</i>	5	



BASHKIA KORÇË

2.2 A janë palët e interesuara të përcaktuara qartë dhe të përzgjedhura në mënyrë strategjike (bashkëpunëtorët, përfituesit përfundimtarë , grupet e synuara)?	5	
2.3 A janë nevojat e grupit të synuar dhe përfituesve përfundimtarë të përcaktuara qartë dhe a i trajton projekti ato në mënyrën e duhur?	5	
2.4 A përfshin projekti vlerë të shtuar, si qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë? <i>Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat sjellin risi në zbatimin e projekteve në bashkinë përkatëse.</i>	5	
2.5 A bën projekti avokim për një qasje të bazuar tek të drejtat dhe a ka ndikim pozitiv tek grupet e pafavorizuara? (Promovimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave, mbrojtja e mjedisit, bashkëpunimi ndërkombëtar, rinia, etj.) <i>Vlerësim maksimal marin aplikimet, të cilat ndikojnë në të paktën 2 grupe të marginalizuara</i>	5	
3. Metodologjia	20	
3.1 A përshtaten plani i aktiviteteve dhe aktivitetet e propozuara në mënyrë logjike dhe praktike me qëllimet dhe rezultatet e pritshme?	5	
3.2 Sa konsistente është skema e përgjithshme e projektit? (veçanërisht, a e pasqyron analizën e problemeve të identifikuar, faktorët e mundshëm të jashtëm) <i>Vlerësim maksimal marin aplikimet, në të cilat janë marë në konsideratë faktorët e jashtëm (sipas logframe) dhe janë prezantuar masa për eliminimin e tyre.</i>	5	
3.3 A është i kënaqshëm niveli i përfshirjes së partnerëve në zbatimin e projektit? Shënim: nëse nuk ka asnjë partner pikët e përfituara do të jenë 1. <i>Këtu nuk përfshihen bashkëpunëtorët.</i>	5	
3.4 A janë përfshirë në projekt tregues objektivisht të matshëm? <i>Vlerësim maksimal marin aplikimet, të cilat në logframe kanë indikatorë të qartë e të matshëm.</i>	5	
4. Qëndrueshmëria	25	
4.1 A do të kenë veprimtaritë e propozuara ndikim konkret tek grupet e synuara? <i>Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat lidhin aktivitetet e propozuara me grupet e synuara.</i>	5	
4.2 A do të ketë projekti ndikime të shumëfishta? (përfshirë mundësinë e zbatimit në grupe të tjera të synuara ose në vende të tjera dhe/ose shtrirjen e ndikimit të veprimtarive si dhe shkëmbimin e informacionit për përvojën e fituar gjatë zbatimit të projektit)	5	
4.3 A janë rezultatet e pritshme të veprimtarive të sugjeruara të qëndrueshme nga ana institucionale? (a do të ekzistojnë strukturat që mundësojnë veprimtaritë e projektit pas përfundimit të projektit? A do të ketë pronësi lokale mbi rezultatet e projektit?)	5	
4.4 A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme? (aty ku është rasti, përmendni ndikimin strukturor të veprimtarive të zbatuara – përmirësime në kuadrin ligjor, metoda, kodin e sjelljes, etj.)	5	
4.5 A ka mundësi që rezultatet/arritjet e pritshme afatgjata do të ndikojnë në kushtet ekonomike lokale dhe/ose cilësinë e jetës në zonën e synuar?		
5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos	15	
5.1 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet shpenzimeve të parashikuara dhe rezultateve të pritshme? <i>Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat kanë respektuar ndarjen e % së aktiviteteve sipas udhëzuesit.</i>	5	
5.2 A është kostoja e sugjeruar e nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
5.3 Buxheti - a është buxheti i qartë dhe a përfshin edhe pjesën përshkruese? (përfshirë shpjegimet për pajisjet teknike) - a përmbushet parimi që kostoja administrative dhe e personelit nuk mund të jetë mbi 30 për qind e buxhetit total? - a është buxheti me ndjeshmëri gjinore? - a janë përfshirë CV-të dhe përshkrimet e punës, aty ku është e nevojshme?	5	
Pikët totale maksimale	100	

Njoftimi rreth vendimit

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet e tyre miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve u njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre brenda 30 ditë pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet shpallen në faqen e internetit të Bashkisë www.bashkiakorçe.gov.al si dhe në tabelën e njoftimeve të bashkisë.

Vendimi për refuzimin e projekt-propozimit apo për mosdhënie fondesh merret nëse:

- Organizata aplikuese, apo/dhe një ose më shumë partnerë të saj, nuk i përmbushin kushtet e thirrjes publike;

**BASHKIA KORÇË**

- Aktivitetet e projektit janë të papranueshme (p.sh. aktivitetet e propozuara tejkalojnë fushë-veprimin e thirrjes publike për projekt propozime, kohëzgjatja e parashikuar e projektit tejkalon kohën maksimale të lejuar, shuma e kërkuar e fondeve tejkalon shumën e lejuar maksimale, dhe/apo shuma e kërkuar e fondeve është më e vogël se minimumi i lejuar, etj);
- Projekt propozimi nuk ka qenë relevant mjaftueshëm; kapacitetet financiare dhe operative të organizatës aplikuese nuk janë të mjaftueshme, apo projektet e përzgjedhura për financim nuk kanë qenë superior në këto fusha;
- Cilësia e projekt propozimit ka qenë teknikisht dhe financiarisht më e ulët në krahasim me projektet e përzgjedhura për financim.

Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, organizatës jofitimprurëse, projekti i së cilës është miratuar, i ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, organizatës mund t'i kërkohej modifikime të caktuara në projekt për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 7 Projekt Propozimi

Shtojca 8 Buxheti

Shtojca 9 Korniza Logjike

Shtojca 10 Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë

Shtojca 11 Formulari i identifikimit administrativ

Shtojca 12 Formulari i identifikimit financiar

Shtojca 13 Deklarata për plotësimin e kritereve

Shtojca 14 Lista e kontrollit

Shtojca A Deklarata e partneritetit

Shtojca B Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit

Shtojca C Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË